



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.09.2020)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Ceremonia e betimit të tetë (8) anëtarëve të rinj të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor të përzgjedhur nga shorti i datës 8 shtator 2020.<sup>1</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:00 dhe mbaroi në orën 10:08.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>   | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>         | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>11. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

<sup>1</sup> Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Merrnin pjesë gjithashtu:

**1. Përfaqësues të stafit administrativ të KLGJ-së.**

**2. Tetë anëtarët e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.**

**3. Përfaqësues të medias.**

## **RENDI I DITËS:**

1. Ceremonia e betimit të tetë (8) anëtarëve të rinj të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor të përzgjedhur nga shorti i datës 8 shtator 2020.

Ceremonia e betimit të tetë anëtarëve të rinj të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor hapet me fjalën hyrëse të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Përshëndetje të nderuar anëtarë!

Përshëndetje të nderuar gjyqtarë

Përshëndetje të gjithë të ftuarve në këta ceremoni!

Kam kënaqësinë dhe privilegjin që në emër të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të hap ceremoninë e betimit të tetë anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Ky proces është i përcaktuar në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Është një proces me përgjegjësi, peshë dhe legjitimitet për ngritjen dhe konsolidimin e institucioneve përfaqësuese, dhe të praktikave që qëndrojnë në themel të shtetit dhe demokracisë në Shqipëri.

Më datë 8 shtator 2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor, hodhi shortin për përzgjedhjen e tetë gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, një proces ky transparent dhe gjithëpërfshirës ku ishin të ftuar përfaqësues të partive politike, organizatave jofitimprurëse me veprimtari në fushën e zgjedhjeve dhe të drejtësisë, dhe përfaqësues të medias.

Të zgjedhur nga një trupë gjyqtarësh të cilët kanë kaluar me sukses, për herë të parë, procesin e rivlerësimit kalimtar, jo vetëm aftësia e tyre profesionale, pasuria, figura por edhe integriteti dhe besueshmëria janë në lartësinë e detyrës. Për të përmbushur pritshmëritë e palëve në procesin zgjedhor por mbi të gjitha të qytetarëve, shoqërisë

shqiptare dhe për të garantuar një proces zgjedhor të lirë, të barabartë, të rregullt dhe të ndershëm.

Të nderuar anëtarë të ardhshëm të kolegjit zgjedhor, ju siguroj që sfidat dhe vështirësitë nuk do të mungojnë, por mbani parasysh misionin tuaj si gjyqtarë por edhe si qytetarë të cilët kontribuojnë në konsolidimin e sistemit demokratik, sundimit të ligjit dhe të ardhmes evropiane të vendit tonë.

Me këtë mesazh, dua të hap ceremoninë e betimit të anëtarëve të rinj të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Sipas radhës, do të lexohen emrat e anëtarëve të Kolegjit, dhe më pas do të vijohet me betimin!

Më tej ftohen tetë anëtarët e rinj të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, sipas kësaj radhe: gjyqtarja {...}, gjyqtari {...}, gjyqtari {...}, gjyqtarja {...}, gjyqtarja {...}, gjyqtarja {...}, gjyqtari {...} dhe gjyqtarja {...}, të bëjnë betimin sipas nenit 146, pika 4, të ligjit 10019, datë 28.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 101/2020.

Përmbajtja e betimit është: “Betohe më solemnisht se do të respektoj, do të mbrojt dhe do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Shqipërisë, se do të respektoj të drejtat dhe liritë e qytetarëve dhe do të përmbush detyrat e mia. Betohe më se do të kryej detyrën time me të gjitha mundësitë e mia dhe në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe pa favorizuar ndonjë person, parti politike apo subjekt zgjedhor”.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.09.2020)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimin nga kandidati z.{...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Illir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:30.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

*10. Marçela Shehu* (anëtare)

*11. Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z.{...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Illir Toska).

*Naureda Llagami:* Çështja e dytë e rendit të ditës, "Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z.{...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit". Për relatin e këtij projekt-akti ia jap fjalën zotit Toska.

*Brikena Ukperaj:* Më fal Kryetare, mund të flas përpara se të marrë fjalën zoti Toska?

*Naureda Llagami:* Brikena, po!

**Brikena Ukperaj:** Proceduralisht kisha një diskutim në lidhje me tre pika të rendit të ditës që kanë të bëjnë me pikën 9, 10 dhe 14. Këto tre pika i referohen verifikimit të plotësimit të kushteve të tre kritereve të kandidimit për tre gjyqtarë që kanë aplikuar në dy pozicione të shpallura si të lira për efekt të ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit.

Çështja është se me vendimet 187 dhe 188 të datës 28.05.2020 ne kemi shpallur dy pozicione të lira për ngritjen në detyrë në këtë gjykatë. Në vijim, në një nga këto pozicione është caktuar zoti {...}, i cili ka filluar ushtrimin e funksionit dhe “de jure” dhe “de facto” për një nga këto pozicione nuk është më i lirë.

Në këto kushte, vlerësoj që nuk mund të vijojë diskutimi për plotësimin nga kandidatët vetëm për efekt të procedurës, jo sepse kam ndonjë diskutim lidhur me plotësimin e kritereve prej tyre, pa u vendosur paraprakisht se çfarë do të bëhet me të dy procedurat, sepse unë personalisht do ta kisha të vështirë të votoj që të vazhdojë procedura e verifikimit dhe nëse kandidatët plotësojnë kriteret e kandidimit për të dyja pozicionet, ndërkohë që për njërin nga këto pozicione, e dimë që nuk është më i lirë.

Nuk e di se si e ka menduar Komisioni i Zhvillimit të Karrierës sepse ndoshta proceduralisht që ne të vendosim se çfarë duhet të bëjmë me dy pozicionet, pra do të bashkonim dy procedurat e ngritjes në detyrë në një procedurë të vetme; do të vendosim përfundimin e njëres, do të vijonim me tjetrën dhe do të vendosim që të gjithë kandidatët të verifikoheshin për efekt procedure dhe në vijim pastaj të vazhdonim me verifikimin e kritereve që të mos kemi vendime të njëpasnjëshme pastaj, mbyllje procedure për një kandidat dhe vazhdimi për tjetrën.

Ky ishte propozimi im që konsiston në faktin që këto tre çështje të shqyrtohen para se Këshilli të vendosë se çfarë do të bëhet me dy procedurat që janë ende formalisht të hapura për efekt të ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit.

**Ilir Toska:** Mund të them diçka?

Nuk mendoj se fakti që ne do duhet të diskutojmë se kush nga këto procedura do duhet të vijojë, nga dy procedurat që kemi hapur në Gjykatën Administrative të Apelit, afekton vendimet e sotme sa i përket verifikimit të plotësimit të tre kritereve për kandidimet e tre kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit.

Në një situatë të mëpasshme mund të vendosim çdo opsion që përmendi zonja Ukperaj dhe kjo nuk do të pengonte dhe as do të çbënte vendimet që ne marrim sot, që kandidati plotëson kriteret për t'u ngritur në detyrë në Gjykatën e Administrative të Apelit. Mund të bashkojmë procedurat, mund të vijojnë të dy procedurat, por kjo është një gjë e dytë. Nëse ne sot vendosim që kandidati plotëson kriteret, atëherë do duhet të fillojmë procedurat për vlerësimin profesional të tyre. Kjo është arsyeja që ne konsideruam që të marrim paraprakisht një vendim për verifikim paraprak të kriterëve, që të fillojë edhe procedura e vlerësimit, pra për të përfunduar sa më shpejt procedurën e ngritjes në detyrë, përfshirë edhe në Gjykatën Administrative të Apelit.

Mendoj që nuk kemi ndonjë pengesë që të vijojmë. Se çfarë do të vendosim në të ardhmen, kjo është një çështje që do zgjidhi edhe situatën e tre kandidatëve që janë sot në shqyrtim. Faleminderit!

**Brikena Ukperaj:** Ilir, më fal që të replikoj.

Plotësimi i kriterëve është dakord për dy pozicione por pika e dytë e çdo vendimi që bën fjalë për tre kandidatët, vijimi i plotësimit të kriterëve të tjera për të dyja pozicionet. Tani, tek një kandidat është ose për njërin ose për tjetrin. Tek njëri është për të dy, tjetri është për një, pavarësisht se e kuptoj ngutshmërinë që ka procesi dhe që duhet të fillojnë vlerësimet e tyre sa më shpejt të jetë e mundur. Proceduralisht, në vlerësimin tim duhet të ndahet njëherë se kush nga këto pozicione ose si do të bëhet me procedurat dhe pastaj të vijojë, që edhe kandidatët të dinë se si do të operohet. Megjithatë, si ta vlerësojë Këshilli. Unë e ngrita si një çështje procedurale që e shikoj të nevojshme për ta diskutuar.

**Naureda Llagami:** Brikena, e ke propozim për ta votuar qëndrimin apo ishte thjesht çështje për ta sjellë në vëmendje në procedurat e mëtejshme?

**Brikena Ukperaj:** Unë e bëra në fakt propozimin dhe vlerësoj që pika 9, 10 dhe 14 të mos shqyrtohen sot por të shqyrtohen pasi Këshilli të vendosë se çfarë do të bëhet me dy procedurat sepse nuk mund t'i themi kandidatëve që ti do vazhdosh procedurën e verifikimit për dy pozicione, ndërkohë që një pozicion ne e dimë mirë që nuk është pozicion i lirë. Kjo ishte e gjitha. Megjithatë, nuk e di! Unë mendoj që afekton.

**Naureda Llagami:** Atëherë, ta hedhim në votim propozimin?

Atëherë, hedhim në votim propozimin e bërë nga zonja Ukperaj lidhur me tërheqjen e dy çështjeve, tre çështjeve në fakt, për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit në një moment tjetër, kur të saktësohet procedura.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Kundër.

**Dritan Hallunaj:** Kundër.

**Ilir Toska:** Kundër.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Kundër.

**Marçela Shehu:** Kundër.

**Erjon Muharremaj:** Pro, me arsyetimin që, në vlerësimin tim kjo është një çështje që ka të bëjë edhe me procesin e rregullt ligjor sa i përket procedurës së kandidimit të secilit prej kandidatëve sepse ata duhet të kenë të qartë momentin final, për sa pozicione janë duke kandiduar. Faleminderit!

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, tre çështjet do shtyhen në mbledhjen tjetër, pasi të vlerësohet lidhur me procedurat.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë në relatimin e çështjes?

**Ilir Toska:** Faleminderit!

Atëherë, kandidati {...} ka kandiduar në ngritjen në detyrë për dy pozicione të lira në Gjykatën e Apelit Tiranë, në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimet 184 dhe 185 të datës 28.05.2020.

Me vendimin nr. 238, 07.07.2020, Këshilli ka vendosur: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, ku pas shortit të hedhur, për kandidatin {...}, si relator për procedurën e verifikimit jam caktuar unë.



Më datën 7 korrik 2020 është bërë njoftimi i kandidatit për fillimin e procedurës së verifikimit si dhe për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit po të çdo anëtari. Nuk ka parashtruar ndonjë pretendim. Ndërkohë sa i përket verifikimit të pasurisë dhe figurës, në kuadër të ngritjes në detyrë në kushtet kur kandidati është subjekt rivlerësimi “ex officio” sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, proces ky që për kandidatin nuk ka përfunduar. I është kërkuar, bazuar në vendimin e Këshillit nr. 75/2019, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në datën 9 korrik 2020 trajtimi me përparësi të procedurës së rivlerësimit kalimtar ndaj kandidatit {...}. Sipas përgjigjes së dhënë nga ana e këtij institucioni, i datës 17.07.2020 ky proces rivlerësimi për kandidatin {...} ka filluar dhe shpresojmë që të përfundojë sa më shpejt.

Ndërkohë, në datën 9 korrik 2020 kandidatit i janë dërguar formularët dhe autorizimet që duhet të plotësojë në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë. Ka depozituar rregullisht dokumentacionin e kërkuar pranë zyrës së protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë në datën 13 korrik 2020, në kuadër të verifikimit të kandidatit {...}, janë kërkuar informacione dhe raportime nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe figurës për të gjithë kandidatët për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit, përfshirë edhe z. {...}, në supozimin që procesi i rivlerësimit për të nuk do të përfundojë me përparësi, do duhet që Këshilli të vijojë ta përfundojë vet procedurën e verifikimit.

Ndërkohë, referuar pikës 9 të vendimit të Këshillit nr. 184 dhe nr. 185 të datës 28 maj 2020, pra ato që janë shpallur pozicionet e lira ku ka kandiduar zoti {...}, është vlerësuar që të bëhet verifikimi paraprak i tre kritereve, asaj të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “papajtueshmërisë ambientale”, me qëllim që krahas procesit të verifikimit, të fillojë edhe procesi i vlerësimit profesional dhe etik për të gjithë kandidatët që konkurrojnë, përfshirë edhe për z. {...}.

Në respektim të dy vendimeve si më lart, janë marrë informacionet nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe i Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, po kështu edhe nga gjykata ku ka ushtruar funksionin e gjyqtarit z. {...}.

Konkretisht është marrë informacion vetëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, pavarësisht se zoti {...} ka punuar edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mirditë, por kjo gjykatë, në kuadër të ristrukturimit është shkrire dhe i gjithë dokumentacioni i saj i ka kaluar për arkivim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Sa i përket verifikimit paraprak të kriterit të “përvojës profesionale minimale”, ndërkohë që zoti {...} konkurren për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, kërkohet sipas nenit 47/4 të ligjit për Statusin, një përvojë e përgjithshme prej 7 vjetësh, nga të cilat 5 vjet në fushën përkatëse të pozicionit ku konkurren, pra në fushën e të drejtës penale.

Nga informacioni i marrë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, rezulton se zoti {...} ka filluar detyrën e gjyqtarit me vendimin nr. 10, datë 20.10.1993 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ku është emëruar gjyqtar në ish-Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mirditë. Ndërkohë, me vendimin nr. 235, datë 24.10.2008 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, ku vijon edhe sot detyrën. Referuar këtyre të dhënave, kandidati rezulton që të përmbushë kriterin e “përvojës profesionale minimale” pra mbi 7 vjet përvojë të përgjithshme.

Nga ana tjetër, referuar informacionit të marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, rezulton që zoti {...} të ketë gjykuar në vijimësi në dhomë penale, me përjashtim të viteve 2010-2011, ku në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë është caktuar në dhomë civile.

Gjithsesi, referuar përvojës në fushën e së drejtës penale, rezulton që kandidati të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës penale.

Sa i përket kriterit të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, kandidati në momentin e kandidimit ka paraqitur një deklaratë me shkrim ku ka deklaruar se nuk ka masë disiplinore në fuqi, ndërkohë që nga informacioni i marrë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, rezulton që zoti {...} të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Ndërkohë është verifikuar edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”. Rezulton se sipas deklaratës së bërë në momentin e kandidimit, kandidati ka deklaruar se nuk do ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë ambientale nëse ngrihet në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, ndërkohë që gjatë verifikimeve nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë e

ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshërisë ambientale për sa ai kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Pas verifikimit paraprak të këtyre tre kritereve, rastin ia kam përcjellë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, i cili në mbledhjen e datës 25 gusht 2020 ka vendosur që çështja t'i kalojë për shqyrtim Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit të tre kritereve formale të kandidimit të zotit {...}.

Mbi sa rezulton nga verifikimi paraprak i tre kritereve, në cilësinë e relatorit i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor që të vendosë: 1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z.{...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z.{...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, nëse nuk keni ndonjë diskutim, kalojmë votimin e projekt-aktit, sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika e 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.09.2020)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimin nga kandidati z. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 223, datë 02.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:30.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

*10. Marçela Shehu* (anëtare)

*11. Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të katër kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 223, datë 02.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen e radhës të rendit të ditës e cila ka të bëjë me verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore nga kandidati z. {...}. Edhe për këtë projekt-akt relator është zoti Ilir Toska.

*Ilir Toska:* Kandidati z. {...} ka kandiduar për pozicionet e lira në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, po kështu edhe për pozicionet e lira në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

Sipas rendit të ditës po vijoj me relatimin e çështjes që i përket kandidimit të z. {...} në ngritjen në detyrën në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Zoti {...} ka kandiduar për pozicionin e shpallur për ngritjen në detyrë në gjykatë me vendimin nr. 223, datë 02.07.2020.

Me vendimin nr. 269, datë 07.08.2020 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 223, datë 02.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur: “1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.223, datë 02.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. 2. Për kandidatin e vetëm z. {...}, i cili ka kandiduar edhe për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, procedura e verifikimit të tij sa i përket pasurisë dhe figurës që është në proces e sipër për këto kandidime, është e vlefshme edhe për kandidimin e tij për pozicionin e lirë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të shpallur me Vendimin nr. 223, datë 02.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Më datë 08.08.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit nr. 75/2019, kandidati është njoftuar për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit dhe faktin që edhe në këtë procedurë verifikimi relator i tij do të jem unë, pasi unë jam caktuar si relator edhe për procedurën e kandidimit të z. {...} në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm. Kandidati nuk ka parashtruar asnjë pretendim në lidhje me këto fakte.

Ndërkohë, referuar disponimit të pikës 2 të vendimit të Këshillit nr. 269, datë 07.08.2020, meqenëse procedura e verifikimit të kriterëve të pasurisë dhe figurës për këtë kandidat është në proces përpara Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ndërkohë që kjo procedurë është përcaktuar nga Këshilli si e vlefshme edhe për procedurën e ngritjes në detyrë të kandidatit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit nr. 75/2019, po në datën 08.08.2020, në rrugë elektronike, kandidatit iu dërguan vetëm dy nga deklaratat dhe autorizimet sipas pikës 6, të këtij seksioni, konkretisht Autorizimi “Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, si dhe

Deklarata “Për dhënien e pëlqimit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale” në kuadër të kësaj procedure ngritjeje në detyrë.

Të dy këto dokumente janë plotësuar nga ana e kandidatit dhe janë dorëzuar rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë, referuar pikës 9 të vendimit të Këshillit nr. 223, datë 02.07.2020, pra vendimi në të cilin është shpallur pozicioni i lirë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ku ka kandiduar zoti {...} është vendosur që të verifikohen paraprakisht 4 kriteret formale të kandidimit për në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me qëllim që të vijojë procedura e vlerësimit profesional dhe etik për kandidatët që do të konkurronin në këtë procedurë ngritjeje në detyrë.

Në respektim të këtij përcaktimi të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga ana ime si relator i çështjes, janë bërë verifikimet për katër kriteret formale për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për kandidatin z. {...}. Është mbledhur dokumentacioni nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor si dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, sa i përket “përvojës profesionale minimale” që është një nga katër kriteret që duhet të verifikohet për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Referuar të dhënave të mbledhura gjatë verifikimit, sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” nga informacioni i marrë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit rezulton se zoti {...} të ketë filluar detyrën si gjyqtar me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.7783, datë 10.10.2012, ndërsa është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në vijim, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.8470, datë 23.01.2014, ai është emëruar përfundimisht gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Më pas, me Vendimin nr. 121, datë 18.11.2016, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. {...} është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku vijon të ushtrijë të njëjtin funksion edhe aktualisht.



Referuar këtyre të dhënave, rezulton që zoti {...} të ketë mbi 7 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë, duke përmbushur kështu një nga kriteret që kërkohet për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, përcaktuar kjo në nenin 47/2/ shkronja “a” të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Sa i përket “përvojës profesionale specifike”, referuar të dhënave të marra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezulton që kandidati z. {...} të ketë qenë kryesisht dhe të ketë ushtruar funksionin e gjyqtarit kryesisht në Dhomë Penale për të gjithë periudhën e përvojës profesionale si gjyqtar.

Nisur nga kjo, rezulton që zoti {...} të përmbushë edhe kriterin e “përvojës profesionale specifike minimale”, pra 5 vjet, siç kërkohet nga neni 47/2, shkronja “a” e ligjit për Statusin.

Sa i përket kriterit tjetër atij të “dhënies së pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, rezulton që zoti {...}, në momentin e kandidimit të ketë depozituar Formularin e “Vetëdeklarimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, Shtojca B, Deklarata 1, plotësuar dhe firmosur rregullisht nga kandidati, z. {...}, që mban datën 13.07.2020; Po kështu, në momentin e kandidimit zoti {...} ka depozituar dhe plotësuar edhe Formularin “Vetëdeklarim, që është i anëtarëve të familjes së gjyqtarëve dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; i prokurorëve dhe punonjësve të tjerë të Prokurorisë së Posaçme; i drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesit, oficerit të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicioneve të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit”, sipas Shtojcës B, Deklarata 3, dokument ky që është plotësuar dhe firmosur rregullisht nga bashkëshortja e kandidatit, znj. {...} {...}, i datës 13.07.2020. Edhe ky formular mban datën 13 korrik 2020.

Sa më sipër rezulton që kandidati dhe familjarët e afërm të tij, në respektim të përcaktimeve ligjore, kanë dhënë pëlqimin e shprehur sipas formularëve përkatëse tip, për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit

nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Për kandidatin z. {...} është verifikuar edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”. Për këtë, kandidati në momentin e aplikimit ka plotësuar formularin tip të miratuar nga Këshillit ku deklaron se nuk ka masë disiplinore në fuqi. Po kështu është marrë informacion nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, referuar dosjes së kandidatit rezulton të mos ketë mase disiplinore në fuqi.

Për kandidatin z. {...} është verifikuar edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale” në rast se ngrihet në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe rezulton që për këtë kriter kandidati të ketë plotësuar formularin tip të miratuar nga ana e Këshillit ku shprehet se nuk do të ketë papajtueshmëri ambientale nëse ngrihet në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Ndërkohë që gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa i kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Sa i përket verifikimit të katër kriterëve si më lart për zotin {...}, rastin ia kam përcjellë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, i cili në mbledhjen e datës 28 gusht 2020 e ka konsideruar të plotë procedurën e verifikimit për këto 4 kriterë, sa i përket kandidimit të zotit {...} në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka vendosur që çështjen t’ia kalojë për shqyrtim Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nisur nga sa rezulton nga verifikimi i katër kriterëve formale të kandidimit të z. {...}, i propozoj Këshillit që të vendosë: Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 223, datë 02.07.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e

organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 223, datë 02.07.2020.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, nëse s’keni ndonjë diskutim, kalojmë miratimin e projekt-aktit, sipas propozimit të bërë nga KZHK?

***Maksim Qoku:*** Dakord.

***Brunilda Kadi:*** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Illir Toska:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Medi Bici:*** Pro.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të katër kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 223, datë 02.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika e 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.09.2020)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimin nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:30.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

*10. Marçela Shehu* (anëtare)

*11. Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës e cila ka të bëjë edhe kjo me shqyrtimin e projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit të kritereve nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor...". Relator i projekt-aktit është sërish z. Ilir Toska.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Atëherë, siç u referua edhe nga Kryetarja sa i përket citimit të pikës së rendit të ditës, z. {...} ka kandiduar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 184, 185 datë

28 maj 2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Lidhur me këto kandidime por edhe kandidimet e tjera për procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 238, datë 07.07.2020 ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit për të gjithë kandidatët. Ndërkohë, pas shortit të hedhur, për kandidatin {...}, si relator për këtë jam caktuar unë.

Procedura e verifikimit ka filluar menjëherë më datë 7 korrik 2020, ndërsa kandidati është njoftuar për fillimin e procedurës si dhe nëse ka pretendime për relatorin apo për çdo anëtar tjetër të Këshilli. Kandidati nuk ka parashtruar asnjë pretendim për relatorin apo anëatrët e Këshillit.

Ndërkohë, sa i përket verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit në kuadër të ngritjes në detyrë, në kushtet kur ai është subjekt rivlerësimi “ex officio” sipas ligjit nr. 84/2016 “Për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, proces ky që për kandidatin nuk ka përfunduar, i është kërkuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimi me përparësi të procedurës së rivlerësimit kalimtar për kandidatin z. {...}. Kjo është bërë me shkresën e datës 9 korrik 2020, bazuar në vendimin e Këshillit nr. 75, të vitit 2019. Është marrë përgjigje nga KPK më datën 17.07.2020, sipas të cilit për kandidatin po vijon procesi i vlerësimit kalimtar duke shpresuar që do të përfundojë me përparësi ky proces përpara KPK-së.

Ndërkohë, më datë 9 korrik 2020 kandidatit i janë dërguar formularët dhe autorizimet përkatëse në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë. Janë plotësuar e dorëzuar rregullisht nga ana e tij. Po kështu, kandidati ka plotësuar edhe formulari i deklaratës së pasurisë që është dorëzuar pranë Institucionit të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit dhe kjo është bërë në vijim të asaj që përmenda edhe më herët, që në supozimin që procesi i vlerësimit kalimtar nuk do të përfundojë me përparësi për kandidatin z. {...}, Këshilli të procedojë vet, sikundër ka vendosur në vendimin e tij nr. 75/2019.

Ndërkohë, referuar pikës 9 të vendimeve me të cilën është shpallur për pozicionet e lira për ngritjen në detyrë ku ka konkurruar z. {...}, Këshilli ka vendosur që të verifikojë paraprakisht çdo kandidat për tre kriteret formale të kandidimit, me qëllim për t'i hapur

rrugë fillimit të procedurës së vlerësimit profesional dhe etik. Edhe për zotin {...} është bërë verifikimi paraprak i tre prej kriterëve formale të kandidimit, konkretisht “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “papajtueshmërisë ambientale”.

Sa i përket këtyre kriterëve është marrë informacion nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit. Sa i përket përvojës profesionale specifike por edhe të përgjithshme, të dhënat u referuan në pikën e mëparshme të rendit të ditës. Kështu e konsideroj tepër t’i përsëris ato të dhëna.

Edhe sa i përket masës disiplinore, u referuan të dhënat e verifikimit në pikën e mëparshme të rendit të ditës sa i përket verifikimit të kandidatit në procedurën e ngritjes në detyrë për në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Sa i përket kriterit të “papajtueshmërisë ambientale”, që është e ndryshme meqenëse kemi një gjykatë të ndryshme, kandidati, në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë ka plotësuar formularin tip e papajtueshmërisë ambientale. Ka deklaruar që nuk do të jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale nëse ngrihet në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë. Ndërkohë që gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë tjetër e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati.

Duke e konsideruar të plotë procedurën e verifikimit të tre kriterëve formale, rastin ia kam përcjellë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, i cili më datë 25 gusht 2020, duke e konsideruar të plotë procedurën e verifikimit të tre kriterëve formale të kandidimit të zotit {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, ka vendosur që çështja t’i kalojë për shqyrtim Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në përfundim të fjalës time, referuar të dhënave të rezultuara gjatë verifikimit paraprak të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për kandidatin z. {...}, i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor që të vendosë verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të kriterëve të “përvojës



profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z.{...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, nëse nuk keni ndonjë diskutim, kalojmë në procesin e votimit të projekt-aktit, sipas propozimit të bërë nga relatori?

***Maksim Qoku:*** Dakord.

***Brunilda Kadi:*** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Illir Toska:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Medi Bici:*** Pro.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika e 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.09.2020)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të gjyqtarit z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Illir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:30.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
11. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
6. *Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
7. *Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të “USAID”.*

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të gjyqtarit z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen e radhës së rendit të ditës e cila ka të bëjë me caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të gjyqtarit z. {...}. Edhe për këtë projekt-akt relator është z. Ilir Toska.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të gjyqtarit z. {...}”.

Krahas projektvendimit ju është përcjellë edhe relacioni shpjegues.

Projektvendimi dhe relacioni është përpiluar bazuar në nenin 135, pika 4, nenin 147, pika 1, nenin 147/a, shkronja “a” dhe nenin 179, pika 8, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 162, pika 2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nuk po citoj dispozitat ligjore, por ju sjell në vëmendje se sipas nenit 162, pika 2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, “Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton në mënyrë të përhershme gjyqtarët në detyrë në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, me kërkesë të tyre, nëse: a) gjyqtari kalon me sukses procesin e rivlerësimit, sipas përcaktimeve të ligjit “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; b) përmbush kriteret për ngritjen në detyrë, sipas përcaktimeve të nenit 47 të këtij ligji; c) gjyqtari, si dhe familjarët e afërm të tij japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 286, datë 18.12.2019 ka vendosur fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 19.12.2019. Sipas këtij vendimi Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda emërtohet Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Për shkak të fillimit të funksionimit të kësaj gjykate, duke qenë përpara detyrimit ligjor mbi caktimin e gjyqtarëve në detyrë të Gjykatës së Krimeve të Rënda përkohësisht ose në mënyrë të përhershme, në varësi të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor mori Vendimin nr.304, datë 18.12.2019, “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të gjyqtarit z. {...}”. Caktimi i përkohshëm i këtij gjyqtari u bë në kushtet e parashikuara nga neni 162, pika 3, e Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi rezultoi se ndaj tij kishte filluar procesi i rivlerësimit, sipas përcaktimeve të Ligjit “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mirëpo në datën 18.12.2019 ende nuk kishte një vendim të formës së prerë për konfirmimin e tij në detyrë, ndërkohë që ai dhe familjarët e tij kishin dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Tashmë rezulton se z. {...} ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit sipas përcaktimeve të Ligjit “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa është konfirmuar në detyrë me Vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 227, datë 17.01.2020, vendim ky që ka marrë formë të prerë pa u ankimuar, më datë 28.07.2020 (referuar faqes zyrtare në internet të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit). Ky fakt, pra mosparaqitja ankimi ndaj vendimit si më lart të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit konfirmohet edhe nga njoftimi publik i datës 29.07.2020 i Institucionit të Komisionerëve Publikë për mosankimim të vendimit të dhënë për subjektin e rivlerësimit z. {...}.

Në këto kushte, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin ligjor për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, të gjyqtarit z. {...}, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në rrethanat kur plotëson kushtet dhe kriteret e kërkuara nga ligji, neni 162, pika 2, i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi: a) ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar; b) përmbush kriteret për ngritjen në detyrë, sipas përcaktimeve të nenit 47, pika 2, shkronja “a”, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa ka ushtruar funksionin e gjyqtarit jo më pak se shtatë vjet, konkretisht mbi 20 vjet, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale; c) ai dhe familjarët e afërm të tij kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tij bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar" (verifikuar në rastin e caktimit të përkohshëm të z. {...} me Vendimin nr.304, datë 18.12.2019 të KLGJ).

Mbi këtë bazë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar projektvendimin “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarit z. {...}”, ku sipas pikës 1 të të cilit, në rrethanat kur z. {...} plotëson kushtet dhe kriteret për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar sipas nenit 162, pika 2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet caktimi në këtë pozicion, në mënyrë të përhershme, të gjyqtarit në fjalë.

Në pikën 2 të projektvendimit parashikohet se një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në pikën 3 të projektvendimit parashikohet e drejta dhe afati i ankimit të gjyqtarit, konkretisht se kundër vendimit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Së fundi, projektvendimi përcakton hyrjen në fuqi menjëherë të tij, si dhe publikimin e vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, nëse nuk keni ndonjë diskutim, kalojmë në miratimin e projekt-aktit.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të gjyqtarit z. {...}”, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika e 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.09.2020)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Illir Toska): “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”; “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”; “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:30.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

*10. Marçela Shehu* (anëtare)

*11. Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".*

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Illir Toska): “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”; “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”; “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Shkodër për një pozicion në fushën e të drejtës civile; “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”; “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”.

Kush do e relatojë këtë relacion nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës?

*Ilir Toska:* Iliri! Është shkruar edhe tek rendi i ditës.

Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur tre projektvendime për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër, pranë Gjykatës së Apelit Korçë dhe pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

Bashkëlidhur projektvendimeve është edhe relacioni shpjegues. Mund t'ju them se: Këshilli i Lartë Gjyqësor pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuar nga ligji, më datë 28.05.2020, hapi procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në disa gjykata apelit të juridiksionit të përgjithshëm, ndër to në Gjykatën e Apelit Gjirokastër për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile sipas Vendimit nr.175, në Gjykatën e Apelit Koçë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale sipas Vendimit nr.177 dhe në Gjykatën e Apelit Shkodër për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile sipas Vendimit nr.178.

Afati i kandidimit për këto tre procedura ngritjeje në detyrë është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë.

Afati i kandidimit për këto tre procedura ngritjeje në detyrë ka përfunduar më datë 15.06.2020.

Brenda afatit të kandidimit në këto tre procedura ngritjeje në detyrë nuk kandidoi asnjë gjyqtar.

Në kushtet e moskandidimit të asnjë gjyqtari në procedurat si më lart të ngritjes në detyrë: - në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile; - në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale; dhe - në Gjykatën e Apelit Shkodër, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, ndërsa vijonte të ekzistonte nevoja për plotësimin e tyre, Këshilli vendosi të rihapte procedurat e ngritjes në detyrë pranë këtyre gjykatave. Konkretisht:

a) me Vendimin nr. 227, datë 02.07.2020, për procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

b) me Vendimin nr. 228, datë 02.07.2020, për procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale;

c) me Vendimin nr. 229, datë 02.07.2020, për procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Në të tre këto procedura ngritjeje në detyrë, afati i kandidimit u përcaktua i njëjti, konkretisht “dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë”.

Vendimet i Këshillit si më lart për rihapjen e procedurës së kandidimit u publikuan në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 03.07.2020, përfshirë dhe njoftimet publike përkatëse sipas fushave të së drejtës për rihapjen e këtyre procedurave. Pas publikimit të vendimeve dhe njoftimeve publike, afati i kandidimit ka filluar të ecë nga dita e nesërme, pra nga data 04.07.2020, duke përfunduar më datë 19.07.2020.

Sikurse edhe më parë, në këto procedura ngritjeje në detyrë pranë gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm nuk kandidoi përsëri asnjë kandidat.

Në kushtet e moskandidimit të asnjë gjyqtari në procedurat si më lart të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale dhe në Gjykatën e Apelit Shkodër, për pozicionin e lire në fushën e të drejtës civile, në këto gjykata vijojnë të ekzistojnë përsëri nevojat urgjente për plotësimin e tyre, plotësim që mund të realizohet vetëm përmes procedurave të ngritjes në detyrë.

Ndaj sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur dhe tre projektvendime për rihapjen e procedurave përkatëse të ngritjes në detyrë respektivisht në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe në Gjykatën e Apelit Korçë. Në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë dhe Shkodër janë për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile, ndërsa për Gjykatën e Apelit Korçë pozicioni i lirë është në fushën e së drejtës penale.

Sipas projektvendimeve të propozuara, afati i kandidimit për secilin nga pozicionet e lira është dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë.

Sa i përket përmbajtjes së projektvendimeve, ato janë të strukturuar në 4 Krerë, me të njëjtën përmbajtje si dhe në rastin e hapjes dhe të rihapjes së këtyre procedurave të ngritjes në detyrë.

Bashkëlidhur projektvendimeve janë edhe dy formularët tip, që kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë në momentin e aplikimit, konkretisht: i) formulari - Vetëdeklarim për masë disiplinore dhe ii) formulari - Vetëdeklarim për situatën e papajtueshmërisë ambientale. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Nëse nuk kemi ndonjë diskutim, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

*Maksim Qoku:* Dakord.

*Brunilda Kadi:* Dakord.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Ilir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e vendimeve “Për rihapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”; “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”; “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”. Afati i kandidimit për këto është dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë.

\* \* \*

(Pika e 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.09.2020)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Illir Toska): “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”; “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”; “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”; “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:30.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)

- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>   | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtar)</b>  |
| <b>10. Marçela Shehu</b>    | <b>(anëtare)</b> |
| <b>11. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>  |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 6. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 7. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të “USAID”.**

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska): “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”; “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”; “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”; “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktet e radhës të cilat kanë të bëjnë me projektvendimet e përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”; “Për rihapjen e

procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”; “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”; “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”. Domethënë, në të njëjtën gjykatë janë 4 pozicione të lira. Lidhur me relatimin e projekt-akteve, fjalën ia jap sërish zotit Toska.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar katër projektvendime “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”. Edhe në këtë rast keni relacionin shoqërues për këto katër projektvendime.

Mund t’ju them që për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor fillimisht hapi 5 procedura ngritjeje në detyrë, pra për 5 pozicione të lira, me vendimet nr. 93, nr. 94, nr. 95, nr. 96 dhe nr. 97, datë 26.02.2020, duke përcaktuar dhe afatet respektive të kandidimit për secilën procedurë ngritjeje në detyrë.

Pas përfundimit të afatit të pezulluar dhe më pas të zgjatur të kandidimit, në procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionin e parë të lirë të hapur me Vendimin nr. 93, datë 26.02.2020, brenda afatit të kandidimit, pra deri më datë 29.04.2020, aplikoi një kandidat, ndërkohë që me Vendimin nr.153, datë 06.05.2020, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin e vetëm për këtë pozicion, duke caktuar dhe relatorin përkatës.

Në procedurat e tjera të ngritjes në detyrë, konkretisht në procedurën e dytë, të tretë dhe të katërt, të hapura me Vendimet nr. 94, nr. 95 dhe nr. 96, datë 26.02.2020, brenda afateve të kandidimit, që kanë përfunduar respektivisht më datë 06.05.2020, më datë 13.05.2020 dhe më datë 20.05.2020, nuk aplikoi asnjë kandidat. Në kushtet e moskandidimit të asnjë gjyqtari në tre procedurat si më lart të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar,



meqenëse vijonin të ekzistonin të tre pozicionet e lira të hapura me Vendimet si më sipër dhe do të duhet të plotësoheshin përmes ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, Këshilli me Vendimet e tij nr. 162, nr. 163 dhe nr. 164, datë 28.05.2020, vendosi të rihapte procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për të tre këto pozicione të lira. Në këtë rast, afati i kandidimit u caktua tre javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë, duke përfunduar ai më datë 22.06.2020. Rezultoi se për këto vende vakante nuk kandidoi asnjë kandidat.

Përveç sa sipër, më pas përfundoi edhe afati i kandidimit për pozicionin e pestë të lirë, të shpallur me Vendimin nr. 97, datë 26.02.2020, afat i cili pasi u zgjat për të njëjtat shkaqe sikurse dhe afatet për pozicionet e tjera, përfundoi më datë 27.05.2020. Edhe për këtë pozicion të lirë pranë të njëjtës gjykatë, nuk kandidoi asnjë kandidat.

Kështu, në total në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar u krijuan katër pozicione të lira, ndërkohë që vijon e njëjta nevojë për plotësimin e tyre. Për këtë arsye, Këshilli me vendimet nr. 220, nr. 221, nr. 222 dhe nr. 223, datë 02.07.2020, vendosi rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për katër pozicione të lira.

Ndërkohë pranë kësaj gjykate, gjyqtari {...}, me vendimin nr. 245, datë 05.03.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit u shkarkua nga detyra, duke krijuar një pozicion tjetër të lirë, i cili do të duhej të plotësohej nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Për rrjedhojë, Këshilli me vendimin nr. 224, datë 02.07.2020, vendosi të hapte procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë.

Vendimet e Këshillit si më lart për rihapjen dhe hapjen e procedurave të kandidimit për në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pra tashmë për 5 pozicione, janë publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 03.07.2020, përfshirë dhe njoftimin publik përkatës për rihapjen dhe hapjen e këtyre procedurave. Pas publikimit të vendimeve dhe njoftimit publik, afatet e kandidimit kanë filluar të ecin nga dita e nesërme, pra nga data 04.07.2020, duke përfunduar kështu më datë 26.07.2020.

Brenda afatit të kandidimit për këto procedura ngritjeje në detyrë, rezulton të ketë kandiduar vetëm një kandidat, z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin nr. 223, datë 02.07.2020, ndërsa për pozicionet e tjera të lira nuk ka aplikuar asnjë kandidat.

Në kushtet e moskandidimit të asnjë gjyqtari në katër procedurat si më lart të ngritjes në detyrë në Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në këtë gjykatë vijojnë të ekzistojnë katër pozicionet e lira si dhe nevojat urgjente për plotësimin e tyre, të cilat duhet të plotësohen përmes ngritjes në detyrë të gjyqtarëve.

Ndaj sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar katër projektvendime për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për katër pozicione të lira.

Sipas projektvendimeve të propozuara, afati i kandidimit është vlerësuar të jetë i njëjti, konkretisht dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për rihapjen dhe hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë.

Lidhur me përmbajtjen e projektvendimeve, për secilën procedurë ngritjeje në detyrë, ato titullohen “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

Sa i përket përmbajtjes së projektvendimeve, ato janë strukturuar në 4 Krerë, me të njëjtën përmbajtje, si dhe në rastin e rihapjes dhe hapjes fillimisht të procedurave për ngritjen në detyrë për këto pozicione të lira.

Bashkëlidhur projektvendimeve janë edhe dy formularët tip, që kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë në momentin e aplikimit, konkretisht: i) formulari - Vetëdeklarim për masë disiplinore dhe ii) formulari - Vetëdeklarim për situatën e papajtueshmërisë ambientale. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin, kalojmë në miratimin e tij?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Më falni se u shkëput linja.

Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e vendimeve “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për katër pozicione të lira”, me afatin e kandidimit i cili është dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor të njoftimit për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë.

\* \* \*

(Pika e 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.09.2020)*

**Pika 8 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Illir Toska): “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”; “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:30.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

*10. Marçela Shehu* (anëtare)

*11. Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të “USAID”.*

#### **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Illir Toska): “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”; “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

*Naureda Llagami:* Atëherë, kalojmë tek projekt-akti i radhës i cili ka të bëjë me shqyrtimin projektvendimit “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për dy pozicione të lira”. Edhe ky projekt-akt do të relatohet nga zoti Illir Toska.

*Illir Toska:* Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur dy projektvendime “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar...” për secilën nga këto procedura bëhet fjalë për një pozicion të lirë.

Mund t’ju them se Këshilli i Lartë Gjyqësor fillimisht ka hapur 5 procedura ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e

Organizuar, respektivisht me vendimet nr. 88, nr. 89, nr. 90, nr. 91 dhe nr. 92, datë 26.02.2020, duke përcaktuar.

Kanë përfunduar aktualisht afatet e pezulluara dhe më pas të zgjatura të kandidimit për të pesta procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në përfundim të afateve të kandidimit, për katër procedurat e para të ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, rezultoi se aplikuan disa kandidatë. Ndërsa, në procedurën e pestë, të hapur me Vendimin nr. 92, datë 26.02.2020, brenda afatit të kandidimit, që përfundoi më datë 27.05.2020, nuk aplikoi asnjë kandidat.

Në kushtet e moskandidimit të asnjë gjyqtari në procedurën si më lart të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe duke qenë se vijonte të ekzistonte ky pozicion i lirë, ai duhet të plotësohej përmes ngritjes në detyrë të gjyqtarëve. Për këtë arsye, me vendimin nr. 225, datë 02.07.2020, Këshilli vendosi të rihapë procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë.

Përveç sa sipër, për shkak se gjyqtarja Nure Dreni, gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin e datës 17.06.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit u shkarkua nga detyra e saj dhe pranë kësaj gjykate u krijua një tjetër pozicion i lirë i përhershëm, me vendimin nr. 226, datë 02.07.2020, Këshilli vendosi të hapte procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për këtë pozicion të lirë.

Në të dyja procedurat si më sipër, për ngritjen në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për të dy pozicione të lira, afati i kandidimit u përcaktua tre javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë.

Vendimet i Këshillit si më lart për rihapjen dhe hapjen e procedurave të kandidimit për në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 03.07.2020, përfshirë dhe njoftimin publik përkatës për rihapjen dhe hapjen e këtyre procedurave. Pas

publikimit të vendimeve dhe njoftimit publik, afatet e kandidimit kanë filluar të ecin nga dita e nesërme, pra nga data 04.07.2020, duke përfunduar kështu më datë 26.07.2020.

Në të dyja këto procedura ngritjeje në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk aplikoi asnjë kandidat.

Në kushtet e moskandidimit të asnjë gjyqtari në procedurat si më lart të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në këtë gjykatë vijojnë të ekzistojnë dy pozicionet e lira si dhe nevojat urgjente për plotësimin e tyre, të cilët duhet të plotësohen përmes ngritjes në detyrë të gjyqtarëve.

Për këtë arsye, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur edhe dy projektvendimet për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për dy pozicione të lira.

Afati i kandidimit, sipas projektvendimeve të propozuara, është dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sa i përket përmbajtjes është i strukturuar në 4 Krerë, me të njëjtën përmbajtje, si dhe në rastin e rihapjes fillimisht të procedurave për ngritjen në detyrë për pozicionin e lirë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Edhe në këtë rast, bashkëlidhur projektvendimeve janë edhe dy formularët tip, që kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë në momentin e aplikimit, konkretisht: i) formulari - Vetëdeklarim për masë disiplinore dhe ii) formulari - Vetëdeklarim për situatën e papajtueshmërisë ambientale. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, nëse nuk keni ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktet, kalojmë në votimin e tyre?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi vendimet lidhur me rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për dy pozicione të lira. Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika e 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.09.2020)*

**Pika 9 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë: 1. në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 183 datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor; 2. në Gjykatën e Apelit Vlorë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 186, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor; 3. në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 188 datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:30.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                                  |                                 |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <b><i>1. Naureda Llagami</i></b> | <b><i>(kryetare)</i></b>        |
| <b><i>2. Maksim Qoku</i></b>     | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b><i>3. Medi Bici</i></b>       | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>4. Fatmira Luli</i></b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>5. Brunilda Kadi</i></b>   | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>6. Dritan Hallunaj</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |

- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| <i>7. Ilir Toska</i>        | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>8. Alban Toro</i>        | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i>   | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>10. Marçela Shehu</i>    | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i>  |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të “USAID”.*

#### **RENDI I DITËS:**

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë: 1. në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 183 datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor; 2. në Gjykatën e Apelit Vlorë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 186, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor; 3. në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 188 datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

**Shënim:** Nën-pika 3 e projektvendimit është shtyrë (shih procesverbalin e pikës së dytë të rendit të ditës).

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë: në Gjykatën e Apelit Tiranë; në Gjykatën e

Apelit Vlorë. Ndërkohë që për Gjykatën Administrative të Apelit, sipas vendimmarrjes së bërë nga ana e Këshillit nuk do të shqyrtohet në këtë mbledhje. Kështu që për pikën 3 të projektvendimit nuk do shprehet Këshilli. Do shprehet vetëm për dy çështjet e para (*shih procesverbalin e pikës së parë të rendit të ditës*).

Ia jap fjalën relatores zonjës Marçela Shehu.

**Marçela Shehu:** Atëherë, kandidati z. {...} ka kandiduar në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe Vlorë, në fushën civile, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 183 dhe nr. 186, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ka vijuar procedura e verifikimit të kriterëve formale për këtë kandidat, bazuar në vendimin nr. 75, datë 23.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Është verifikuar “përvoja e përgjithshme profesionale”, “përvoja specifike profesionale”, kriteri i “papajtueshmërisë ambientale” dhe i “mospasjes së masave disiplinore në fuqi”. E gjithë procedura e verifikimit është e relatuar në mënyrë të detajuar në relacionin që ju tashmë e keni prej disa ditësh përpara.

Pas verifikimeve të kryera rezulton se kandidati zoti {...} plotëson të gjitha këto kriterë, pra rezulton të ketë mbi 7 vjet përvojë profesionale të përgjithshme si gjyqtar i shkallës së parë. Rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë specifike në fushën e së drejtës civile. Nuk rezulton të ketë masa disiplinore në fuqi dhe nuk ka probleme lidhur me kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

Në këto kushte unë si relatore i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën Apelit Tiranë dhe Vlorë, në fushën civile, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 183 dhe nr. 186, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes së masës disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votim?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 183, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor; në Gjykatën e Apelit Vlorë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 186, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika e 9 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.09.2020)*

**Pika 10 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për dy pozicione të lira të shpallura me vendimin nr. 187 dhe nr. 188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:30.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të “USAID”.*

**RENDI I DITËS:**

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për dy pozicione të lira të shpallura me vendimin nr. 187 dhe nr. 188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

*Naureda Llagami:* Atëherë, projekt-akti që është në shqyrtim, pika 10 e rendit të ditës “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për dy pozicione të lira...” do të shtyhet, pas vendimit që mori Këshilli, do të shtyhet në një mbledhje tjetër. *(Shih procesverbalin e pikës së dytë të rendit të ditës.)*

\* \* \*

(Pika e 10 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.09.2020)*

**Pika 11 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë: në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 171, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor; në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 181 dhe nr. 182, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:30.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| <i>7. Ilir Toska</i>        | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>8. Alban Toro</i>        | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i>   | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>10. Marçela Shehu</i>    | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i>  |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të “USAID”.*

#### **RENDI I DITËS:**

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë: në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 171, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor; në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 181 dhe nr. 182, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu)

*Naureda Llagami:* Ndërkohë që kalojmë tek çështja tjetër e cila ka të bëjë me verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile. Për më shumë detaje fjalën ia jap sërish zonjës Marçela Shehu.



**Marçela Shehu:** Kandidati z. {...} ka kandiduar për tre pozicione në fushën e së drejtës civile, në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura konkretisht me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 171, nr. 181, nr. 182, datë 28.05.2020.

Ka nisur procedura e verifikimit lidhur me këtë kandidat. E gjithë procedura e verifikimit është e detajuar në relacionin e përgatitur nga unë si relatore dhe që ju e keni në dispozicion.

Ka rezultuar se kandidati {...} përmbush të gjitha kriteret që përcakton ligji lidhur me kandidimin e tij në Gjykatën e Apelit. Ai plotëson kriterin e “përvojës profesionale të përgjithshme” sepse rezulton të ketë mbi 7 vjet si gjyqtar i shkallës së parë. Rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë në fushën civile, pra plotëson edhe kriterin e “përvojës profesionale specifike”. Rezulton të mos ketë probleme me “papajtueshmërinë ambientale” dhe nuk rezulton të ketë masa disiplinore në fuqi.

Në këto kushte, unë i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë verifikimin e plotësimit nga ky kandidat në procedurat e ngritjes në detyrë për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 171, nr. 181 dhe nr. 182, datë 28.05.202 të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes së masës disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit nëse nuk keni kundërshtime?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

***Medi Bici:*** Pro.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë: në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 171 datë 28.05.2020; në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 181 dhe nr. 182, datë 28.05.2020, dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika e 11 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.09.2020)*

**Pika 12 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 182, nr. 183 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:30.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>      | <b>(anëtar)</b>          |

8. *Alban Toro* (anëtar)  
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)  
10. *Marçela Shehu* (anëtare)  
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoresh pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
6. *Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
7. *Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".*

#### **RENDI I DITËS:**

12. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 182, nr. 183 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kritereve ligjore nga kandidatja znj. {...}. Për më shumë detaje, fjalën ia jap sërish znj. Marçela Shehu.

*Marçela Shehu:* Kandidatja gjyqtarja znj. {...} ka kandiduar për tre pozicione të lira, konkretisht për dy pozicione të lira në fushën civile, pozicione të shpallura këto me vendimet e nr. 182 dhe nr. 183, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe për pozicionin e lirë të shpallur në fushën e të drejtës penale me nr. 185, datë 28.05.2020.

Është realizuar edhe për këtë kandidate procedura e verifikimit të kritereve ligjore në përputhje me vendimin nr. 75, datë 23.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor si dhe në përputhje me parashikimet e Ligjit për Statusin.

Ka rezultuar se kjo kandidate i plotëson të gjitha kriteret që përcakton Ligji për Statusin lidhur me ngritjen në detyrë në gjykatën e apelit. Ajo rezulton të ketë mbi 7 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e shkallës së parë. Rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale specifike si në fushën penale ashtu edhe në fushën e së drejtës civile. Nuk rezulton të ketë masa disiplinore në fuqi, si dhe nuk ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale, në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Në këto kushte, unë i propozoj me cilësinë e relatores, Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë verifikimin e plotësimit nga kjo kandidate të këtyre kritereve që citova. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, keni ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 182, nr. 183 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin

e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika e 12 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 10.09.2020)***

***Pika 13 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 181, nr. 183 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 184, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Pika 14 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, për njerin nga pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 187 ose nr. 188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:30.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i>   | <i>(kryetare)</i>        |
| <i>2. Maksim Qoku</i>       | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i>         | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>4. Fatmira Luli</i>      | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>5. Brunilda Kadi</i>     | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i>   | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>7. Ilir Toska</i>        | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>8. Alban Toro</i>        | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i>   | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>10. Marçela Shehu</i>    | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>11. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i>          |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".*

#### **RENDI I DITËS:**

13. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 181, nr. 183 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 184, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit" i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).



14. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, për njerin nga pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 187 ose nr. 188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për dy pozicione të lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 181, nr. 183 dhe për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 184, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit. Dhe për këtë projekt-akt fjalën ia jap sërish zonjës Marçela Shehu.

*Marçela Shehu:* Kandidatja gjyqtarja znj. {...} ka kandiduar për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 181, nr. 183 dhe nr. 184, pozicione këto që lidhen me fushën civile dhe penale. Vendimi nr. 184 bën fjalë për pozicionin e lirë në fushën penale dhe dy pozicione të lira në fushën e së drejtës civile.

Edhe për zonjën {...} ka vijuar verifikimi i përmbushjes së kritereve ligjore në referim të vendimit nr. 75, datë 23.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky verifikim i detajuar ndodhet në relacionin që ju tashmë e keni në dispozicion. Ka rezultuar nga verifikimi që kandidatja znj. {...} i plotëson kriteret që kërkon ligji lidhur me kandidimin e saj. Ajo rezulton të ketë mbi 7 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë. Rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale specifike në fushën e së drejtës civile dhe penale. Nuk rezulton të ketë masa disiplinore në fuqi dhe nuk vërtetohet që kjo kandidate të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rastin e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Në këto kushte, në cilësinë e relatores i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor, të verifikojë plotësimin nga kandidatja znj. {...} për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 181, nr. 183, dhe nr. 184 të kritereve të “përvojës profesionale

minimale” të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Ndryshe kalojmë në votimin e projekt-aktit.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësisimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 181, nr. 183 dhe për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 184, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ndërkohë që lidhur me pikën e 14, siç morëm vendim, edhe kjo pikë do të shtyhet në një mbledhje të ardhshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor (*shih pikën e dytë të rendit të ditës.*)

Atëherë, me kaq përfunduar mbledhjen e radhës.

**Marçela Shehu:** Kryetare, më fal mund të them diçka të lutem?

Unë vetëm sot në fakt konstatova që lidhur me kandidaten {...}, e cila ka kandiduar edhe ajo për tre pozicione në gjykatën e apelit dhe për të cilën është kryer verifikimi dhe është dërguar edhe relacioni, nuk është përfshirë në rendin e ditës. Mbase është ndonjë lapsus apo pasaktësi nga ana e administratës. Por unë vlerësoj se duke qenë se ajo nuk ka kandiduar për pozicione në Gjykatën Administrative të Apelit, pra nuk përbën pengesë shqyrtimi i saj në këtë mbledhje, atëherë duke qenë se edhe anëtarët janë njohur me relacionin, pasi ka disa ditë që është dërguar, unë propozoj që të përfshihet në rendin e ditës, më shumë për të mos humbur edhe koherencën ecuria e këtyre vendimmarrjeve dhe për t'u përfshirë më pas në procesin e vlerësimit.

**Naureda Llagami:** Lidhur me çështjen që ju referuat, do jetë në mbledhjet e ardhshme, pa diskutim, pa humbur asnjë lloj vonese për sa i përket shqyrtimit të saj, bashkë me aktet e kandidatëve të saj.

**Marçela Shehu:** Bëra propozim për ta përfshirë sot.

**Naureda Llagami:** Dakord. Kalojmë në votim propozimin tuaj.

**Maksim Qoku:** Unë dola nga linja. A mund të... dhe nuk e dëgjova.

**Naureda Llagami:** Atëherë, për të gjithë anëtarët, Marçela propozoi që të shtohet në rendin e ditës shqyrtimi i projektvendimit lidhur me verifikimin dhe plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për zonjën {...}, projekt-akt i cili nga ana e relatores dhe Komisionit i është përcjellë anëtarëve, por që në cilësinë time të Kryetares nuk e kam përfshirë në rendin e ditës për datën 10 shtator, për ta lënë në vijim. Meqë relatorja bën një propozim për një shtesë në rendin e ditës të këtij projekt-akti, atëherë unë e hedh në votim, kështu që ju ftoj të votoni lidhur me propozimin e bërë nga zonja Shehu nëse duhet futur sot për shqyrtim në rendin e ditës apo jo.

**Marçela Shehu:** Dëgjo, të theksoj diçka. Kjo edhe mund të shtyhet për një mbledhje tjetër. Problemi është që nuk ka asnjë dallim nga kandidatët që kishim sot dhe nëse Komisioni i Vlerësimit do të vijojë me procedurat, më mirë të kalojë edhe verifikimi i kësaj kandidateje (në qoftë se të gjithë janë njohur me relacionin).

**Naureda Llagami:** Marçela, këtë gjë ta thashë që në fillim kur e hodhe propozimin.

Ngule këmbë dhe the: -“Jo, e dua në votim”.

Tani, a ka mundësi ta qartësojmë?

**Marçela Shehu:** Dakord. Dakord.

Okej, dakord.

**Naureda Llagami:** Nga ana ime, në mbledhjen e ardhshme do jetë pjesë e rendit të ditës, si shumë çështje të tjera që i kemi urgjente. Nëse e ke propozimin për votim?

**Marçela Shehu:** Po! – e kam propozimin. Faleminderit!

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Kundër.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Iliri nuk votoi.

**Ilir Toska:** Po pra, se kaluat shpejt.

Atëherë, unë mendoj që të shtyhet sepse nuk është vetëm zonja {...}, por ishin edhe disa kandidatë të tjerë që ne si Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i kemi përcjellë Këshillit për shqyrtim. Bëhet fjalë që janë të gjithë kandidatët që sot ne i betuam, janë anëtarë të Kolegjit Zgjedhor. Është ngërçi që kemi referuar mbi caktimin e bërë në Kodin Zgjedhor. Kështu që mendoj që ta shtyjme për momentin.

**Marçela Shehu:** Ilir, e mendova, por kandidatët e tjerë kanë kaluar. Zonja {...}, me sa di unë, e ka kaluar procesin e verifikimit.

Okej, dakord! Por nuk është ky shkak.

**Ilir Toska:** Ky ishte mendimi im. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Vijojejmë votimin të lutem!

**Erjon Muharremaj:** Kundër, pas sqarimeve që dha zoti Toska.

**Brikena Ukperaj:** Kundër, për arsye sepse nuk jam njohur me relacionin edhe pse e kam në adresën e e-mailit. Kam lexuar vetëm relacionet e ditës së sotme; por edhe për faktin e relatuar nga zoti Toska.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Fatmira?

**Fatmira Luli:** Votova “Pro”.

**Marçela Shehu:** Pro.

*Naureda Llagami*: Kundër.

Atëherë, me shumicë votash, çështja nuk përfshihet në rendin e ditës. Do jetë në mbledhjet e ardhshme.

Me kaq po e mbyll edhe mbledhjen e sotshme.

Punë të mbarë!

\* \* \*

(Pika e 13 dhe 14 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**